



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT  
SEKRETARIATI

Nr. 765/Prot  
17

Tiranë, më 17.12.2013

**Z. LULZIM BASHA**  
KRYETAR BASHKIA TIRANË ✓

**Z. LORENC LUKA**  
KRYETAR BASHKIA SHKODËR

**Z. VIKTOR TUSHAJ**  
KRYETAR BASHKIA LEZHË

**Z. VANGJUSH DAKO**  
KRYETAR BASHKIA DURRËS

**Z. ELVIS RROSHI**  
KRYETAR BASHKIA KAVAJË

**Z. FATOS TUSHE**  
KRYETAR BASHKIA LUSHNJE

**Z. FADIL NASUFI**  
KRYETAR BASHKIA BERAT

**Z. BAFTJAR ZEQAJ**  
KRYETAR BASHKIA FIER

**Z. SHPËTIM GJIKA**  
KRYETAR BASHKIA VLORË

**Z. STEFAN ÇIPA**  
KRYETAR BASHKIA SARANDË

**Z. FLAMUR BIME**  
KRYETAR BASHKIA GJIROKASTËR

**Z. QAZIM SEJDINI**  
KRYETAR BASHKIA ELBASAN

**Z. ARTAN SHKËMBI**  
KRYETAR BASHKIA POGRADEC

**Z. SOTIRAQ FILO**  
KRYETAR BASHKIA KORÇË

Për dijeni:

**Z. EDI RAMA**  
KRYETAR I KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT ✓

**Z. SAIMIR TAHIRI**  
MINISTËR I BRENDSHËM  
(Kryetar i Task-Forcës për Marrjen e Masave të Ndërhyrjes Emergjente për Mbrojtjen Mjedisore dhe Rehabilitimin e Territorit) ✓

**Z. ZYHDI DAJTI**  
KRYEINSPEKTOR I INUK, TIRANË ✓

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 5, datë 18.10.2013, të KKT-së.

I nderuar z. Kryetar i Bashkisë,

Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 18 Tetor 2013, mori vendimin nr. 5 për “Masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”. Vendimi është botuar në Regjistrin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe është dërguar me shkresë përcjellëse pranë institucioneve që ngarkohen për zbatimin e tij, përfshirë edhe njësitë e qeverisjes vendore.

Megjithatë, në ndërkokë, pranë institucionit tonë janë adresuar vazhdimisht pyetje dhe kërkesa për shpjegime të detajuara lidhur me zbatimin e këtij vendimi. Nisur nga detyrimi për dhënie informacioni të hollësishëm në mbështetje të bashkërendimit vertikal midis autoritetave kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësisë kombëtare e vendore në fushën e planifikimit të territorit, vlerësojmë të nevojshme për të shpjeguar më të detajuar objektin e këtij vendimi.

Konkretisht:

Vendimi motivohet nga gjendja e emergjencës në territor, e cila trëgon se fenomeni i mungesës së kontrollit mbi asetat e territorit të Republikës, apo abuzimit me to, është shtrirë e ka përfshirë edhe pasuritë e vlerat e trashëgimisë ambientale, kulturore dhe historike.

Objekti i këtij vendimi janë zonat me rëndësi kombëtare, për të cilat ka akte të miratuara nga organet përkatëse qëndrore të vendimmarjes e ku përfshihen: qendra, zona dhe rajone, të banuara ose të pabanuara, me vlerë arkeologjike, historike, etnologjike, arkitektonike dhe inxhinierike, ansamble urbane, arkitektonike dhe historike, ndërtimore ose konstruktione ndërtimore me vlera të veçanta; të gjitha objektet e ndërtuara: kala, kështjella, qytete antike, parqe arkeologjike, rrënoja antike; si edhe objektet e kultit: kisha, katedrale, manastire, teqe, vende të shenjta.

Në vijim, ju bëjmë me dije se për zbatimin e vendimit nr. 5, datë 18.10.2013, lidhur me masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore, duhet t'i referoheni zonave të listuara në inventarët e përditësuar të Ministrisë së Kulturës për trashëgiminë kulturore materiale të paluajtshme.

Ndërsa lidhur me masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë historike duhet t'i referoheni vendimeve përkatëse të KRRTRSH-së dhe/ose KKT-së për miratimin e kufirit dhe/ose studimit urbanistik të qendrës së qytetit tuaj.

Theksojmë se, Këshilli Kombëtar i Territorit, me anë të vendimit nr. 5 për "Masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore", dhe listës së inventarit të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme, ndër të tjera vendosi:

- Pezullimin e dhënies së të gjitha llojeve të lejes zhvillimore në këto zona, nga autoritetet e planifikimit deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (*pika 2*).
- Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, autoritetet e planifikimit lejohen të jepin leje zhvillimore në këto zona zona, vetëm për këto raste përashtimore:
  - a. Punime mirëmbajtjeje;
  - b. Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar (*pika 3*).

Për sa më sipër, ju njoftojmë se në përbushje të pikave 6 dhe 7 të vendimit nr.5 të KKT-së, datë 18.10.2013, ngarkoheni në veçanti për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

Bashkëlidhur gjeni:

- Kopje të vendimit nr. 5 për "Masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike"
- Vendimin e KRRTRSH-së nr.3, 21.08.2002, "*Për dhënien e lejeve të ndërtimit në qendrat e qyteteve*".
- (Për Bashkinë Tiranë) Vendimin e KRRTRSH-së nr. 1, datë 27.04.2004, "*Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Tiranës*" shoqëruar me hartën përkatëse.

Njëkohësisht nga IMK dhe/ose Drejtoria Rajonale e Monumenteve sipas përkatësisë, duhet t'ju kenë vënë tashmë në dispozicion hartën dhe listën e inventarit të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme për njësinë tuaj vendore. Nëse jo, ju mund të kërkonit hartën dhe listën e inventarit të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme, drejtpërdrejt nga këto institucione.

Në çdo rast mbetemi në dispozicionin tuaj për sqarime dhe mbështetje të mëtejshme.

Me respekt,

ADELINA GRECA

SEKRETARE

KËSHILLI KOMBËTARI TERRITORIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, datë 18.10.2013

PËR

MASAT EMERGJENTE TË NDËRHÝRJES MBROJTËSE  
DHE REHABILITUESE MJEDISORE NË ZONAT ME RËNDËSI  
KOMBËTARE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE HISTORIKE

Në mbështetje të nenit 6, 8, nenit 32, të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e atyre zonave ku do të ndërmerrin masa të natyrës emergjente me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të zonave me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike, sipas listës së inventarit të Ministrisë së Kulturës dhe hartave ilustruese në funksion të listës.
2. Pezullimin e dhënies së të gjitha llojeve të lejes zhvillimore në këto zona, nga autoritetet e planifikimit, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.
3. Deri në miratimin e e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, autoritetet e planifikimit lejohen të jepin leje zhvillimore në këto zona, vetëm për këto raste përashtimore:
  - a) Punime mirëmbajtjeje;
  - b) Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.

4. Ministria e Kulturës të bëjë evidetimin dhe përditësimin e të dhënave për monumentet e kulturës, zonat muze, ansambël muze, ansambël monument kulture, qendra historike dhe parqet arkeologjike si dhe të përcaktojë rregullat që kanë ndikim në planifikimin e territorit për secilën kategori.
5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale dhe Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, për marrjen e masave emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në këto zona.
6. Ngarkohen autoritetet e planifikimit për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRETARI**

**EDI RAMA**



ZËVENDËS KRYETARE E K.K.T

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

*Adele Greca*





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

**V E N D I M**  
**NR. 3 DATË 21.08.2002**  
**PËR**  
**DHËNIEN E LEJEVE TË NDËRTIMIT NË QENDRAT E QYTETEVE**

Në mbështetje të Ligjit 8405 dt. 17.09.1998 "Për Urbanistikën", ndryshuar me Ligjin 8501 dt. 16.06.1999 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8405 datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën" dhe në zbatim të V.K.M.Nr.627 dt. 24.12.1997 "Për krijimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqiperisë", ndryshuar me V.K.M.Nr.753 dt. 27.11.1998 dhe Nr.125 datë 4.04.2002;

duke marë në konsideratë mendimin e Sekretarisë Teknike të KRRTRSH, KRRTRSH;

**V E N D O S I :**

1. Sheshet dhe lejet e ndërtimit, për objekte që propozohen brenda zonës së Qendrave të qyteteve për Bashkinë e Tiranës dhe Bashkitë e kategorisë së parë (sipas nenit 15 të Ligjit Nr.8405 dt. 17.09.1998 "Për Urbanistikën"), të shqyrtohen vetëm pas miratimit përfundimtar në KRRTRSH të studimeve të reja për këto qendra, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2. Me "Studim të ri të Qendrës", do të nënkuptohen studimet e bëra dhe miratuar në KRRTRSH pas 1 Janarit 2003.

Kufijtë e zonës së Qendrës për këto qytete të përcaktohen nga Bashkitë përkatëse, në bashkëpunim me Ministrinë e Rregullimit të Territorit është Turizmit, Institutin e Studimeve dhe Projekteve Urbanistike, Institutin e Monumenteve të Kulturës, si dhe Struktura të Akademisë së Shkencave sipas rastit.

3. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Institut i Studimeve dhe Projekteve Urbanistike, Institut i Monumenteve të Kulturës, Struktura të Akademisë së Shkencave dhe Bashkitë e qyteteve sipas pikes 1, me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.



**PER SEKRETARINE TEKNIKE TE KRRT TE REPUBLIKES SE  
SHQIPERISE**

**SEKRETARE**

  
**SHPRESA LEKA**

**KRYETARI**

  
**ARTAN LAME**